



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2977 Prot.

Tiranë, më 29.06/2021

URDHËR

Nr. 321, datë 29.06.2021

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.326, DATË 15.05.2020 “PËR KUFIZIMIN E
AKTIVITETEVE SPORTIVE” TË NDRYSHUAR DHE LEJIMIN E KAMPIONATEVE
SPORTIVE ME PREZENCË TË TIFOZËVE ME KAPACITETE TË REDUKTUARA
DERI NË 30%**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 7, pika 4 gërma b të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, si edhe Vendimit të Komitetit Teknik nr. 2435 datë 27.05.2021,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e Urdhrit Nr.326, datë 15.05.2020 “Për kufizimin e aktiviteteve sportive” të ndryshuar.
2. Lejohen kampionatet sportive me prezencë të tifozëve me kapacitete të reduktuara deri në 30% sipas protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 01.07.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu